

FJALA E DEPUTETIT PETRIT VASILI

E ENJTE 30 QERSHOR 2022

E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Do të thosha edhe “e nderuar qeveri”, por numri është kaq i papërfillshëm, saqë nuk e meriton këtë përcaktor. Sot jemi thirrur për të diskutuar një akt normativ, i cili, do ta thosha që në fjalinë e parë, është as më shumë, as më pak, një paçavure bataçinjshe që duan të grabisin. E them këtë gjë dhe jam i detyruar ta them deri në fund, pa menduar se e teproj aspak, sepse, mendoni që vjen akt normativ, do të shpërndahen para dhe këto para nuk di njeri në këtë sallë me saktësi se sa janë. Madje, edhe vetë qeveria, kur e ka miratuar këtë akt, në relacionin e saj zyrtar, i cili ndodhet këtu në duart tona, nuk ka asnjë shifër të vetme.

Mendoni, pra, që në imagjinatën e tyre këta kanë disa para, që i paguajnë taksat e shqiptarëve një për një, por këta e quajnë, i bëjnë të tyret dhe i ndajnë, i shpërndajnë siç duan ata. Me një fjalë, e quajnë buxhetin pronë të tyre. Nuk e dinë se është një e mirë publike e përbashkët që administrohet, pra kanë të drejtën e administrimit, por ka të drejtën e kontrollit shumë të fortë nga opozita dhe nga gjithë të tjerët. E kjo shifër nuk është. Të thuhet me gojë sa të dojë, por një qeveri vërtet bataçinjshe guxon të kalojë miliona euro, sepse efekti me miliona do të jetë, dhe këto miliona nuk e di njeri se sa janë.

Së dyti, të gjithë duan të dinë minimumin: cilat janë kompanitë që përfitojnë? I kemi pyetur edhe në komisione. Thonë se janë nja 300. Po çfarë janë këta 300, numra? A kanë emër e mbiemër dhe secila prej tyre duhet të ketë në krah edhe masën e përfitimit. Ta dinë të gjithë shqiptarët se përse do të kompensojmë, përse do të paguajnë nga taksat e tyre dhe kujt ia paguajnë? Ç’është ky, sekret? Paratë e kujt po japin, po e ripërsëris, paratë e xhepit po japin këta? Jo, more, është paraja publike. Nuk e kanë mbledhur këta, e kanë mbledhur të gjithë qytetarët që kanë kontribuar në atë buxhet të madh shteti që kemi atje.

Më tutje, vijmë në një akt normativ i cili na thotë edhe për disa artikuj. I ka ndarë nja 8 artikuj. Dukshëm, klientela politike ka përcaktuar edhe artikujt, se kushdo që hap një preventiv ndërtimi, shikon që larmia e materialeve është e shumtë dhe të gjitha mund të ishin afektuar nga çmimi, por ata që janë grosistët e mëdhenj të këtyre materialeve, edhe qeveria, e kanë bërë siç duhet pazarin e tyre dhe janë përcaktuar edhe artikujt. Po mirë, more zotërinj të dashur, për këta artikuj, meqenëse kanë shkallë rritjeje të ndryshme, pse nuk u thoni shqiptarëve që këtë tubin e famshëm plastik ne do ta kompensojmë deri në kaq për qind, këtë hekurin deri në kaq për qind? Dhe shqiptarët dinë sa para dalin nga xhepat e tyre, kush i përfiton dhe sa është maksimumi që mund të përfitojë secili prej tyre.

Në të kundërt, kjo është një hajdutëri ditën për diell, sepse të gjithë do të mendojnë edhe një pyetje tjetër: nga do të merren këto para? Sepse buxheti i shtetit ka ardhur këtu në Kuvend dhe është ndarë me zëra se ku do të shpenzohet çdo lek. Kushdo nga këta që ka qeverisur e di këtë gjë, pavarësisht se janë bërë noterë qesharakë të çdolloj paturpësie që vjen në këtë Kuvend. Ku do t'i marrin paratë? Thonë që afërsisht mund të jenë 60 milionë euro. Kështu thonë, por mund të jenë edhe më shumë, po të marrim këtë që thonë me fjalë, se me të shkruar s'kanë gjë. Ku i marrin paratë? Ku janë këto fonde? Se këtu s'i kanë. Pse nuk ka një akt, që të shoqëronte ligjin ku të thuhet: "Po, për të kompensuar këta, paratë do t'i marrim, këtu, këtu dhe këtu". Sepse çdo shqiptar e di që të gjitha paratë e buxhetit të shtetit janë ndarë sipas zërave. Kanë ndonjë xhep më vete këta?

Pastaj të vijmë te thelbi i çështjes, të gjithë ata që e dëgjojnë këtë seancë, pavarësisht se ata që duhet ta dëgjojnë nuk janë këtu, sepse e kanë bërë adetin, kanë bërë noterin pa sy, pa veshë, pa gojë, kanë hedhur votën dhe kanë ikur, prisnin të dëgjonin, pse sot. Meqenëse këta thonë: "Nuk i lëmë shqiptarët vetëm", jo lënë, por i lënë vetëm në mes të katër rrugëve. 249 lekë shitet karburanti në pikat shqiptare të karburantit, ndërsa në Maqedoni është 211 lekë në të njëjtën ditë. Këtë t'u shpjegojnë shqiptarëve dhe mos nxitohen të zënë ndonjërin me një bidon naftë, sepse shqyrr Zotit që e ka shtëpinë afër me kufirin dhe ka mundësi të blejë naftë më lirë. Por këta kanë hallin që në çdo litër nafte, duhet të marrin pjesën e tyre, qeveria me oligarkët e naftës dhe me ata të bordit të kryehajdutëve. Një bord kryehajdutësh.

Nuk është as bord komunist, as bord fashist, por është bord hajdutësh, këtë emër ka. Të jenë të qetë nga këto përcaktimet ideologjike. Kështu e ka bordi emrin bordi “bord kusarësh”. Çmimet këto janë. Këtë kanë leverdi bashkëatdhetarët tanë që i kanë shtëpitë afër kufirit, të bëjnë pazar, qoftë edhe për artikujt e ushqimeve të shportës. Për këta nuk ka asnjë kompensim. Lekë ka vetëm për tenderët, që i kanë dhënë me 99,99% të çmimit. Kokërr më kokërr i kanë dhënë tenderët. Këta, kështu në rresht siç janë, turpin e hanë me bukë nga mëngjesi deri në darkë. Një amendament kam paraqitur në dhjetor për 2 miliardë lekë të rinj, që kishte të bënte me kompensimin e të sëmurëve me Covid që trajtohen në banesë, por të gjithë e votuan kundër, ndërsa këtë rreckën e bataçinjtë që kanë sjellë këtu, aktin normativ e votuan pro.

Të jeni të bindur, pro e keni, pa diskutim. Pra, të sëmurëve që luanin me jetën nuk u rimbursuan para, s’u dhanë asnjë kokërr leku, me vrap në rresht e votuan kundër, edhe sot e kësaj dite. Se dëgjova njëherë këtu që tha: “E kemi përballuar me dinjitet pandeminë”. Të jesh edhe i pacipë, edhe kriminel, edhe pa zemër, edhe i pandjeshëm, por edhe llapaqen, vetëm këta mund ta bëjnë. S’janë mbi 1 milionë e 200 mijë ose 1 milionë e 500 mijë raste që kanë kaluar COVIDin. Vetëm dje ka pasur 500 raste. Vetëm për minimumin e trajtimit, për trajtimin e zakonshëm mjekësor, janë shpenzuar dhjetëra dhe qindra milionë euro, kurse këta kanë rimbursuar gjithsej vetëm 400 mijë euro. 200 e ca milionë euro kanë dalë nga xhepat e shqiptarëve dhe thonë: “E kemi përballuar me dinjitet pandeminë, s’i kemi lënë vetëm shqiptarët”. Jo vetëm, por i kanë lënë në skamje.

Ka shumë njerëz që krahas kurimit të të afërmeve të tyre, u ka ikur mendja nga stresi për të shlyer borxhet që kanë marrë për të kuruar të dashurit e tyre. Ndërsa këta thonë: “S’i kemi lënë vetëm”. Jo vetëm, por për faqe të zezë i keni lënë. Ndërkohë që këta dalin dhe mbajnë fjalim këtu, shqiptarët po e paguajnë karburantin sa frëngu pulën, baras me Zvicrën, me Suedinë dhe me Danimarkën. S’ka subvencione për ata, nuk preket taksa. Po këtu, në këtë Parlament, e kam thënë me dhjetëra herë (por këta e kanë zënë Parlamentin për gryke, edhe Parlamenti është pronë e tyre, sikurse dhe arka e shtetit është pronë, e tyre), që në mars kam sjellë një projektligj, një amendament për pezullimin e taksës së qarkullimit dhe të karbonit, për të ulur çmimin e naftës, për ta çuar çmimin afërsisht sa të Maqedonisë.

Jo vetëm që nuk e miratojnë, por as diskutimin nuk e fillojnë. Çfarë është ky propozim? Për një emergjencë. Këtë emergjencën e tenderxhinjve të tyre e sjellin me vrap, e kalojnë me vrap, kurse propozimin për emergjencën që bën opozita e mbajnë për gryke, sepse kanë komisionin përkatës dhe nuk e fusin fare për ta diskutuar. Thonë: “E kemi pro këtë, nuk e diskutojmë fare”. E çfarë janë këta? Po një gjë mbetet dhe këtë s’ia heq dot njeriu nga mendja, që mundësi për të bërë mirë kanë plot, por qytetarëve nuk u bëjnë asgjë gjë, zero, kurse për tenderxhinjtë, fiksojeni në mendje, i kanë gati milionat dhe janë të pa kursyer për t’ua dhënë ato miliona.

Gjithashtu, vetëm fakti që mijëra dhe mijëra fermerë merohen dhe torturohen dhe produktet e tyre shiten në mënyrën më qesharake, ku vidhet haptazi djersa e tyre, gjaku i tyre, se bujqësia një sektor kaq i madh, ka zero zhvillim, ndërkohë që po këta, brohorasin paturpësisht, kjo është tallja më e rëndë. Çdo shqiptar, sa herë t’i dëgjojë, duhet ta ketë shumë të qartë që vetëm do të mashtrohet dhe një ditë akoma më e varfër e pret në ditët që do të vijnë. Faleminderit!